

EDUKIMI MBI HIV – KOPSHTI (KINDERGARTEN)

Mësimet e kopshtit përfshijnë konceptet dhe aftësitë themelore që nxënësit do t'i nevojiten për shëndetin gjatë gjithë jetës, si dhe për përgatitjen për mësimet e ardhshme mbi parandalimin e HIV-it.

Mësimi #	Titulli i Mësimi	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Të Jemi të Shëndetshëm	- Të mësojmë zakonet bazë për të ruajtur shëndetin e mirë. - Të praktikojmë sjellje të shëndetshme për të ruajtur ose përmirësuar shëndetin.
2	Të Ndalojmë Mikrobet Që në Fillim	- Të mësojmë si mikrobet shkaktojnë sëmundje. - Të mësojmë mënyrat e ndryshme për të parandaluar përhapjen e mikrobeve dhe për t'u mbrojtur nga sëmundjet.
3	Trupi Im i Mrekullueshëm Më Përket Mua!	- Të mësojmë pjesët e trupit që lidhen me sistemin imunitar dhe termat mjekësore për organet gjinitale. - Të mësojmë të njoftojmë një të rritur të besuar nëse dikush na prek në mënyrë të pasigurt ose na bën të ndihemi në siklet.
4	Kufijtë e Shëndetshëm të Trupit Tim	- Të vendosim kufij dhe të mësojmë si të respektojmë kufijtë e të tjerëve. - Të mësojmë se askush nuk ka të drejtë të prekë dikë pa lejen e tij/saj. - Të mësojmë të njoftojmë një të rritur të besuar nëse dikush na prek në mënyrë të pasigurt ose na bën të ndihemi në siklet.
5	Gjej të Rriturit e Mi të Besuar	- Të kuptojmë çfarë është besimi dhe çfarë e bën një të rritur të besuar. - Të identifikojmë të rritur të besuar që mund të ndihmojnë kur dikush është i sëmurë ose ndihet i pasigurt.

EDUKIMI MBI HIV – KLASA E PARË

Mësimet e klasës së parë përfshijnë koncepte dhe aftësi themelore që nxënësit do t'i nevojiten për shëndetin gjatë gjithë jetës, si dhe për përgatitjen për mësimet e ardhshme mbi parandalimin e HIV-it.

Mësimi #	Titulli i Mësimi	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Sëmundjet: Si i Marrim, dhe Si i Parandalojmë	- Të mësojmë si disa sëmundje përhapen lehtë, disa vështirë, dhe disa nuk mund të kalohen nga një person te tjetri. - Të mësojmë si të parandalojmë përhapjen e mikrobeve, përfshirë edhe rëndësinë e vaksinave.
2	Sistemi Imunitar Superhero!	- Të mësojmë çfarë janë mikrobet dhe si ato mund të shkaktojnë sëmundje. - Të kuptojmë si funksionon sistemi imunitar.
3	Të Mësojmë për Kufijtë	- Të mësojmë si të komunikojmë kufijtë tanë. - Të mësojmë si të përballojmë refuzimin (si të sillemi kur një mik thotë “jo”).
4	Të Jemi Miq të Dobishëm	- Të kuptojmë çfarë e bën një mik të mirë dhe si të jemi të tillë. - Të identifikojmë një të rritur të besuar që mund të ndihmojë një mik që ka nevojë për mbështetje për të qenë i shëndetshëm dhe i sigurt.
5	Të Ndërtojmë Empatinë	- Të përkufizojmë çfarë është empatia. - Të mësojmë si të sillemi me të tjerët me empati për të ruajtur miqësi të shëndetshme.

EDUKIMI MBI HIV – KLASA E DYTË

Mësimet e klasës së dytë përfshijnë koncepte dhe aftësi themelore që nxënësit do t'i nevojiten për shëndetin gjatë gjithë jetës, si dhe për përgatitjen për mësimet e ardhshme mbi parandalimin e HIV-it.

Mësimi #	Titulli i Mësimi	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Mikrobet Na Sëmurin	- Të mësojmë si mikrobet mund t'i bëjnë njerëzit të sëmurë. - Të mësojmë mënyra të ndryshme për të forcuar sistemin imunitar dhe për të parandaluar sëmundjet. - Të krijojmë qëllime të shëndetshme për t'i ndihmuar trupit të luftojë sëmundjet.
2	Sistemi Imunitar i Pafundmë!	- Të kuptojmë si funksionon sistemi imunitar për të luftuar mikrobet. - Të mësojmë zakone bazë për të mbajtur sistemin imunitar të shëndetshëm.
3	Të Kuptojmë Sëmundjet Kronike	- Të mësojmë dallimin midis sëmundjeve kronike dhe jo kronike. - Të praktikojmë mënyra për të treguar mirësi ndaj dikujt që ka një sëmundje kronike.
4	Siguria e Gjakut	- Të kuptojmë se disa sëmundje mund të përhapen përmes gjakut. - Të praktikojmë sjellje të shëndetshme për të parandaluar përhapjen e mikrobeve kur ka prani gjaku.
5	Siguria me Ilaçet	- Të kuptojmë si dhe pse duhet të marrim ilaçet në mënyrë të saktë. - Të identifikojmë të rritur të besuar që mund të ndihmojnë dikë që është i sëmurë ose ka nevojë për ndihmë.

EDUKIMI MBI HIV – KLASA E TRETË

Mësimet e klasës së tretë përfshijnë koncepte dhe aftësi themelore që nxënësit do t'i nevojiten për shëndetin gjatë gjithë jetës, si dhe për përgatitjen për mësimet e ardhshme mbi parandalimin e HIV-it.

Mësimi #	Titulli i Mësimi	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Zakone të Shëndetshme të Higjienës	- Të mësojmë rëndësinë e higjienës personale. - Të krijojmë një qëllim për të filluar ose për të vazhduar një zakon të shëndetshëm.
2	Të Flasim për Mikrobet	- Të mësojmë për lloje të ndryshme mikrobesh dhe si ato mund të shkaktojnë sëmundje. - Të praktikojmë larjen e duarve për të parandaluar përhapjen e mikrobeve.
3	Komunikimi i Simptomave	- Të mësojmë për simptomat bazë që tregojnë se dikush mund të jetë i sëmurë. - Të mësojmë si të flasim me të rritur të besuar rreth simptomave të sëmundjeve.
4	Çfarë është HIV?	- Të përkufizojmë HIV-in dhe ndikimin e tij në sistemin imunitar. - Të mësojmë si mund të transmetohet HIV-i nga një person te tjetri përmes gjakut dhe si nuk mund të transmetohet. - Të kuptojmë se HIV-i është një sëmundje me të cilën njerëzit mund të jetojnë dhe ta menaxhojnë gjatë gjithë jetës.
5	Tre Hapat për Marrjen e Vendimeve për Shëndetin	- Të identifikojmë faktorët që ndihmojnë njerëzit të marrin vendime të shëndetshme. - Të praktikojmë si të bëjmë një zgjedhje të shëndetshme duke përdorur hapat e marrjes së vendimeve.

EDUKIMI MBI HIV – KLASA E KATËRT

Mësimet e klasës së katërt përfshijnë koncepte dhe aftësi themelore që nxënësit do t'i nevojiten për shëndetin gjatë gjithë jetës dhe për të zhvilluar ndjeshmëri ndaj njerëzve që jetojnë me HIV.

Mësimi #	Titulli i Mëimit	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Sëmundjet Ngjitëse	- Të mësojmë dallimin midis sëmundjeve që mund dhe që nuk mund të përhapen nga një person te tjetri. - Të përshkruajmë simptomat e sëmundjeve të zakonshme. - Të identifikojmë një të rritur të besuar për të kërkuar ndihmë nëse kemi një problem që lidhet me shëndetin.
2	Bazat e HIV-it	- Të mësojmë dallimin midis HIV-it dhe SIDA-s. - Të kuptojmë si mund dhe si nuk mund të transmetohet HIV-i tek një person tjetër.
3	Komunikimi Efektiv dhe Shëndeti Ynë	- Të mësojmë mënyra për të komunikuar qartë me të tjerët. - Të praktikojmë si të flasim me të tjerët për HIV-in.
4	Të Avokoj për Vetën Time	- Të mësojmë çfarë do të thotë të mbrosh (avokosh) veten dhe të tjerët. - Të mësojmë si të flasim për veten nëse trajtohem në mënyrë të padrejtë ose kemi nevojë për ndihmë nga të tjerët.
5	Të Avokoj për Të Tjerët	- Të mësojmë çfarë do të thotë të jesh paragjykses dhe si të njohim shembuj të paragjykitimeve. - Të krijojmë një plan avokimi për të adresuar një problem në komunitetin e shkollës.

EDUKIMI MBI HIV – KLASA E PESTË

Mësimet e klasës së pestë përfshijnë koncepte dhe aftësi themelore që nxënësit do t'i nevojiten për mësimet e ardhshme mbi HIV-in, si dhe për të ruajtur shëndetin gjatë gjithë jetës dhe për të treguar ndjeshmëri ndaj njerëzve që jetojnë me HIV.

Mësimi #	Titulli i Mëimit	Kuptimi dhe Aftësitë Kryesore
1	Çfarë Dini për HIV-in?	- Të mësojmë mënyrat bazë se si HIV-i mund të transmetohet nga një person te tjetri. - Të kuptojmë se njerëzit që jetojnë me HIV mund të kenë jetë të shëndetshme duke marrë medikamente.
2	Çfarë është Stigma?	- Të përkufizojmë çfarë janë stigma dhe diskriminimi. - Të mësojmë si të trajtojmë njerëzit që jetojnë me HIV, apo me çdo sëmundje tjetër fizike ose mendore, si anëtarë të barabartë, me drejtësi dhe mirësi.
3	Identifikimi i Informacioneve të Besueshme për Shëndetin	- Të identifikojmë të rritur të besuar dhe burime të përditësuara me të dhëna të sakta për të mësuar rreth HIV-it dhe SIDA-s. - Të mësojmë si të vlerësojmë një burim informacioni për të përcaktuar nëse përmban të dhëna të sakta për HIV-in.
4	Të Avokojmë për Komunitete të Shëndetshme	- Të mësojmë për të drejtat që kanë të gjithë fëmijët në Nju Jork për kujdes shëndetësor dhe arsim. - Të identifikojmë pengesat që mund ta bëjnë të vështirë për disa fëmijë të ndjekin shkollën ose të marrin kujdes shëndetësor. - Të praktikojmë mënyra për të avokuar për ndryshime që përmirësojnë shëndetin e fëmijëve në Nju Jork.
5	Respekt për të Gjithë	- Të rishikojmë hapat që mund të përdoren për të avokuar për veten dhe për të tjerët. - Të praktikojmë si të reagojmë në një situatë kur dikush ngacmohet ose paragjykohet për shkak të një problemi shëndetësor.